



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 5170
Datë: 9/12/2022

Mbështetur në nenin 17 të Kodit të Etikës për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës (Nr. 1/751, dt. 19/07/2013), sidomos dispozitave të neneve 6, 7 dhe 8 të Rregullores për Masat dhe Procedurat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të Universitetit të Prishtinës dhe Rregulloren e Punës të Këshillit të Etikës (Nr. 1/629, dt. 14/07/2016), Statutin e Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Etikës, njëzëri, në mbledhjen e mbajtur me datën 25/11/2022, mori këtë:

VENDIM

- I. Këshilli i Etikës konfirmon vendimin të datës 16.6.2022, me nr. prot. 1/388 për shqiptimin e masave ndëshkuese ndaj Prof. Dr. Bujar Dugolli.**

- II. Këshilli i Etikës konsideron se masat e shqiptuara janë meritore, të drejta dhe proporcionale dhe respektojnë në tërësi kuadrin normativ të UP-së.**

Arsyetim

I. Paraqitja, vlerësimi dhe kualifikimi i të gjeturave faktike

Me datën 20 shtator 2022, Senati i Universitetit të Prishtinës ka kthyer për rishqyrtim vendimin e Këshillit të Etikës për rastin e Prof. Dr. Bujar Dugolli me nr. të protokollit 1/388, datë 16.6.2022 me arsyetimin se i njëjti nuk është në përputhje me dispozitat e Rregullores me nr. prot. 857, datë 11.4.2017, për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP-së. Senati i UP-së pretendon se masat ndëshkuese të shqiptuara si dhe forma e vendimit nuk janë në përputhje me Rregulloren në fjalë.

Këshilli i Etikës konsideron që vendimi i datës 16.6.2022, me nr. prot. 1/388 reflekton në tërësi kuadrin normativ të UP-së, dhe masat ndëshkuese të shqiptuar për Prof. Dr. Bujar Dugolli është i bazuar, është drejtë dhe është proporcionale.


L. M.

Këshilli i Etikës ka konstatuar se mund të nxjerrë vendim meritor dhe se ky vendim mund të konsiderohet i organit të shkallës së parë, kund të cilit pala mund të paraqet ankesë në organin e shkallës së dytë. Palë e legjitimuar për ankesë kundër këtij vendimi është edhe pala denoncuese dhe pala e denoncuar.

II. Vendimi

Duke marrë për bazë të gjitha rrethanat e rastit, në tërësinë e tyre faktiket ligjore, dhe në veçanti kompetencat dhe detyrat, Këshilli i Etikës të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për dhe në emër të Këshillit të Etikës



Prof. Dr. Iset Morina

Kryesues